




Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes: <i>PER</i>	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së <i>B. Kumi</i>
Nga:	Shkëlqim Jakupi, Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave MAPL - <i>Shk</i> Datë: 04/05 /2018 Nr. 020-435
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit
Lloji i aktit:	☐ Vendim


I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr.12/ 464/19444 për shfuqizimin e vendimit nr. 463-34434 të datës 20.06.2016 me të cilin prona e paluajtshme e komunës nr. 726/15 në zonën kadastrale drenas ishte dhënë në shfrytëzim afatgjatë kompanisë "Valdrini" SHPK në sipërfaqe 1.22.00 ^{ha}
I miratuar më datë: 29.04.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.04.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të komunës së lart cekur, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Ramiz Lladrovci, gradonačelnik Opštine Glogovac Labint Halilaj, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac	
Cc:	Jednici za administraciju dokumenata u MALS-u Jednici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko: PER:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Shkëlqim Jakupi, rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština- MALS	Datum, 04/05 /2018 Br. 020-435
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine	
Vrsta akta:	☐ Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,

Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obaveznu rapsravu zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-40 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 12/464/19444 za ukidanje Odluke br. 463-34434 od dana, 20.06.2016. godine, sa kojom nepokretna imovina opštine br. 726/15 u katastarskoj zoni "Drenas" data je na dogoročno korišćenje kompaniji "Valdrini" SHPK u površini od 1.22.00 ^{ha}
Usvojena dana, 29.03.2018. godine,
Predložena za razmetranje u MALS-u dana, 06.04.2018. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je sa proceduralnog aspekta isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr 464-13444 dt. 06.06.2018

ADRIAN K. KOSOVSKI REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministristvo Lokalne Samouprave / Administration Ministry of Local Government Administration			
Data Date			
12.06.2018			
Nr. i dokumentit No. of document		1010-435	

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe nenit 40 pika 40.2 nën 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34 pika 34.6 të statutit të Komunës si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-463-15202 të datës 15.03.2018 të komisionit mbi vlerësimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale kompanisë “Valdrini”shpk, për Pronën Komunale të marrë në shfrytëzim të përkohshëm nga Komuna e Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të datës 29.03.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS NR.463-34434
TË DATËS 20.06.2016, NË NGASTREN KADASTRALE 726/15 NË ZONËN
KADASTRALE NË DRENAS, QË I ISHIN DHËNË NË SHFRYTEZIM
KOMANISË “VALDRINI” SHPK

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet Kthimi i Prones Komunale në Zonen Kadastrale në Drenas, gjegjesisht parcela 726/15 në sipërfaqe 1.22.00 Ha, të cilat i ka pasur në shfrytëzim kompania “Valdrini” Shpk.

Neni 2

Shfuqizohet Vendimi Nr.463-34434 i datës 20.06.2016 i Kuvendit të Komunës së Drenasit, me të cilat vendim i është dhënë prona komunale në shfrytëzim kompanisë “Valdrini” sipërfaqja prej S=1.22.00 Ha sipas afatit të shfrytëzimit afatgjatë prej 45 vitesh.

Neni 3

Me këtë vendim do të njoftohet kompania “Valdrini”shpk.

Neni 4

Per zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labiriot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



Nr. 463 - 34434 dt 20.06.2016

Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 3 pika 1.4 si dhe nenit 6 të Ligjit për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës Ligjit Nr. 04/L-144, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të komunës Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogocit) si dhe propozimit të komisionit për dhënjën e pronave në shfrytëzim nr.12 463-30345 Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me dt.10.06.2016 miratoi këtë:

VENDIM
PËR DHËNIEN E PRONES SË PALUAJTSHME KOMUNALE NË SHFRYTËZIM
AFATGJATË

Neni 1

Aprovohet vendimi i komisionit Nr.12-463-30345 për ndarjen e parcelave të dhëna në shfrytëzim për përiudhën afatgjatë sipas ligjit Nr.04/L-144 për dhënjën e tokave në shfrytëzim.

Neni 2

Ndarja e parcelave ka qenë në përputhje me ligjin për dhënjën e tokave në shfrytëzim Nr. 04/L-144 dhe kriteret e konkursit të shpallur në bazë të numrit të punëtorve, vlerës investive, çmimit të ofruar, dhe veprimtarisë që zhvillon.

Neni 3

Ipet në shfrytëzim Prona e paluajtshme e Komunës me sa vijon:

- Emri i përfituesit: "Valdrini" SH.P.K
- Zona Katastrale :Drenas,nr i parces 726/15
- Vlera investive :460.000,00 euro
- Numri i punëtorve : 6 vende pune
- Gjithësejt Sipërfaqja e pranuar : 1 ha e 22 ari
- Afati i shfrytëzimit të pronës është 45 vjet.

Neni 4

Obligohet Drejtorati për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit që të jap pëlqimin për lokacionin e caktuar

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Kadastrës , Gjeodezi dhe Pronë të bënë bartjen e kësaj palujtshmërie në emër të shfrytëzuesit në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite në regjistrin e RDPP në emër të firmes kontraktuse "Valdrini" SH.P.K

Neni 6

Obligohet kryetari i komunës që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të lidh kontratë me firmën duke ju permbajtur vendimit të marrë në kuvend që të ruhet destinimi i sipërfaqeve dhe hapësirave të objektit ekzistues si: hapsirat pritjes, sportelat, peronat, të respektohet PZHK dhe urban i Drenasit për nenkalim si dhe të lirohet zona e rrugës

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit nga Kuvendi i Komunes dhe vlersimi i MAPL-së

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj

ARSYETIM

Me vendimin Nr. 463-34434 i datës 20.06.2016 Kuvendi i Komunës së Drenasit i ka dhënë në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite kompanisë “Valdrini” shpk pronën komunale gjegjësisht ngastrën kadastrale nr. 726/15 në sipërfaqe prej S=1.22.00 ha në zonën kadastrale në Drenas.

Sipas vendimit vlere e investimit në atë ngastër kadastrale ka qenë 460.000.00 euro nga ana e kompanisë “Valdrini” shpk, pastaj punësimi i 6 punëtorëve etj, ndërsa sipas marrëveshjes së partneritetit publiko privat 01 Nr.344-123 e datës 04.01.2013 “Vëllezërit Thaçi” kanë nënshkruar marrëveshjen për objektin të cilin komuna ja ka dhënë në koncesion (stacionin e autobusëve dhe objekteve përcjellëse) në vlerën e investimit prej 6.500.000,00 pra shihet një dallim në mes të investimit të dy kompanive.

Nga komisioni konstatohet se kjo ngastër kadastrale nuk ka pasur ndryshime edhe pse me vendim të Kuvendit të Komunës së Drenasit i është dhënë në shfrytëzim për 45 vite Kompanisë “Valdrini” shpk pra nuk është lidhur kontrata në mes të kompanisë “Valdrini” shpk dhe kryetarit të komunës.

Me Vendimin Nr. 463-34434 i datës 20.06.2016 Kuvendi i Komunës së Drenasit i ka dhënë në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite kompanisë “Valdrini” shpk, është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, kur kemi parasysh se kjo prone në kohën kur i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë të lartpërmendurit ka qenë nën hetime nga ana e organeve kompetente.

Me që nuk ka ndërhyrje në regjistrim të kësaj kompanie për këtë pronë në sistemin e RDPP-së, sipas raportit të komisionit për vlerësimin e procedurave, kryetari i Komunës i rekomandon kuvendit të komunës së Drenasit që këtë vendim për dhënie të pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë kompanisë “Valdrini” shpk ta shfuqizoj me një vendim të Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Nga të gjitha që u thanë me lart u propozoj asamblistëve të komunës së Drenasit që në harmoni me legjislacionin në fuqi të Shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Drenasit Nr. 463-34434 i datës 20.06.2016, me të cilat vendime i është dhënë prona komunale në shfrytëzim kompanisë “Valdrini” shpk në sipërfaqe prej S=1.22.00 Ha, sipas afatit të shfrytëzimit afatgjatë prej 45 vitesh, dhe ti kthehet prona komunës së Drenasit.

Me respekt!

15/05/18

GA 1463 15202

Duke e zbatuar vendimet e Kryetarit të Komunës së Drenasit nr. 942-12800 dhe 942-12794, pastaj vendimin nr.942-12875 dhe vendimin nr.942-12806 si dhe vendimin nr.020-13532 të marrur me datë 05.03.2018 është formuar komisioni në përberje prej 5 anëtarësh lidhur me vlersimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim të pronave komunale të komunës së Drenasit, komisioni në përberje të plotë ka trajtuar të gjitha rastët sipas vendimeve dhe në fund ka përgatitur këtë:

R A P O R T

MBI VLERSIMIN E ZBATUESHMERISË SE PROCEDURAVE LIGJORE PËR DHENJËN E PRONAVE KOMUNALE NË SHFRYTËZIM DHE PËRMBUSHJËS SE OBLIGIMEVE KONTRAKTUESE

I. Komisioni në përberje të plotë ka filluar me punë sipas vendimeve të marra nga Kryetari i Komunës së Drenasit me datë 07.03.2018 nga ora 13.

Fillimisht komisioni ka pranuar dokumentacionin e fotokopiuar nga zyra e shefit të kabinetit të kryetarit dhe nga zyrtari i RDPP-es për trajtim për ngastrat kadastrale dhe ate:

- Për ngastrën kad. Nr. 258/1,258/2 dhe 258/3 të zona kadastrale Sankoc
- Për ngastrat kad. Nr.98/3 dhe 98/4 zona kadastrale Qikatova e Re
- Per ngastrat kadastrale nr. 720 dhe 127 në Zonën kadastrale Korrotica e Ultë
- Për ngastrat kad. Nr.726/15 zona kadastrale në Drenas

~~Për ngastrën kad. Nr. 258/1~~ zona kadastrale Sankoc



Komisioni pasi mori dokumentacionin zyrtar të fotokopiuar fillimisht trajtoj ngastrat kad. 258/1,258/2 dhe 258/3 Z.kad. Sankoc.

Komisioni konstaton se për keto ngastra kadastrale sipas një vendimi të Kuvendit të Komunës së Drenasit 12 nr.400-37904 të dt. 07.07.2016 (i rexhistruar si Vendim Paraprak) për dhënje në shfrytëzim afatgjatë të tokave komunale personave fizik dhe juridik

Sipas këtij vendimi konstatojmë se veq jan lejuar keto ngastra kadastrale për të u dhënë në shfrytëzim afatgjatë,por tjetër document nuk ka se I janë dhënë ndokujti.

Nga historiat i marr në RDPP shifet se këto tri ngastra kadastrale gjegjësisht ngastra 258/1,258/2 dhe 258/3 kan qenë pronë komunale e Komunës së Drenasit.(deshmi libri kadastral).

De fakto tash nga RDPP i kemi tri Qertifikata mbi të drejtat e pronësore për keto tri ngastra kadastrale të nxjerra nga zyra e kadastrit në komunën tonë se keto tri ngastra kadastrale tash pas shpronësimit nga ana e Qeverisë së Kosovës kanë kaluar në pronësi shtetërore në emër të MKRS-së-Stadiumi Kombëtar I Kosovës.

Komisioni vlerëson se procedura sipas Vendimit paraprak nuk kanë vazhduar me tej dhe ngastrat kadastrale të shenuara me lartë pas shpronësimit me vendim të Qeverisë së Kosovës dhe zbatimit të atij vendimi në RDPP në komunën e Drenasit veç është përfunduar si procedurë administrative.

Komisioni nuk ka Rekomandim për zyrën e Kryetarit lidhur me këtë lëndë pasi që është vendim i Qeverisë së Kosovës, por i propozohet zyrës së Kryetarit të Komunës së Drenasit që me kërkesë të i drejtohet MMPH-Departamentit për shpronësim që të i behet kompenzimi i pronës komunale të shpronësuar nga Qeveria e Kosovës i cili shpronësim është bërë për ndërtimin e stadionit nacional (tri ngastrat kadastrale dhe ato 258/1, 258/2 dhe 258/3) z.kad. Sankoc.

II. Komisioni vazhdoi me trajtimin e procedurave ligjore dhe dokumentacionit për ngastrat kadastrale nr. 98/3 dhe 98/4 të zona kadastrale Qikatova e Re.

- Në dokumentacionin e fotokopiuar për ngastrën kadastrale nr.98/3 kemi Aktvendimin 07.nr.353/180/1 të dt.14.10.1992 (vendim i masave të dhunshme të Serbisë) me të cilin i është dhënë prona komunale (për ndërtim individual të objektit) në sipërfaqe prej $S=0.04.00$ ha në Z. kad. Qikatova e Re. Zejnullah Strumcakut ngaq fshati Abri e Epër.

- Pastaj Kontrata për shitblerjen e këtij trolli në sipërfaqe prej $S=0.04.00$ ha e lidhur në mes të Zejnullah Strumcakut (shitës) dhe Qazim Goranit nga Pokleku (blerës) e cila kontratë edhe është e vertetuar në Gjykatën komunale në Prishtinë në numrin 1654 të dt. 14.08.2000

- Aktvendimi i Drejtoratit për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Drenasit nr.952/26 i dt. 08.03.2005, me të cilin aktvendim i është refuzuar kërkesa për rexhistrim në RDPP të këtij truelli, me arsyetim se nuk ka pasur të drejt të tjetërsimit të pronës nga Zejnullah Strumcaku në emër të Qazim Goranit.

- Aktvendimin nr.03/224/09 të dt.29.04.2009 me të cilin AKK Ja në Prishtinë ia aprovon ankesën dhe e detyron Drejtorinë për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë të Komunës së Drenasit që ta rexhistron këtë truall në emër të Qazim Goranit.

- Pasi që Komuna nuk e ka zbatuar detyrimin për regjistrim të asaj ngastre-trualli, AKK në Prishtinë me Aktvendimin nr. 03/824/09 të dt. 02.02.2011 ka bërë ekzekutimin e aktvendimit të vetë me nr. 03/224/09 të dt. 29.04.2009 dhe e ka rexhistruar vetë drejtperdrejt truallin në emër të Qazim Goranit nga Pokleku nga Pokleku.

- Me vonë Drejtorati për kadaster Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Drenasit ka bërë azhurimin e në RDPP me datë 15.07.2015 dhe e ka lëshuar Qertifikatën mbi të drejtat e pronës së

paluajtshme dhe ate si (lloj I pronës -pronë private) në emer të Qazim Goranit dhe aty ku është l shenuar emri, është shfrytëzues l perhershëm.

Komisioni konstaton se procedura administrative ka parregullsi dhe përkunder asaj që Drejtorati për kad. Gjeod. dhe pronë ia ka refuzuar kërkesën për rexhistrim në RDPP.

Kur themi se ka parregullsi, vejmë në pah se ngastra kadastrale e shenuar në emer të Qazim Goranit nuk ka mundur të tjetersohët nga Zejnullah Strumcaku si shitës.

Prap edhe pse AKK në Prishtinë e ka futur në system na nuk mund ta hjekim nga sistemi por l permenduri sipas dispozitave në arsyetim të Aktvendimit të ZKK-Drenas del se e ka humbur të drejtën e ndertimit ngase ate kusht të ndertimit është dashur ta permbush mbrenda tri vitesh.

Komisioni konstaton se për këtë lëndë pasi që është një lëndë e vjeter nuk kemi mundur me verifikuar në tersi procedurat administrative ligjore të asaj prone, andaj nuk kemi rekomandim për zyrën e Kryetarit të komunës.

Ndersa të rexhistrimi l ngastrës kadastrale nr. 98/4 në emer të Hajdar Hetës komisioni gjatë procedimit të kësaj lënde trajtoj komplet dokumentacionin që nga fillimi duke vlersuar procedurën e ndarjës dhe rexhistrimit në RDPP të ngastrës kad. Nr. 98/4.

-Komisioni në fillim konstatoi se kjo ngastër kadastrla me aktvendimin 07.nr.353-142 të dt. 30.04.1993 l është ndar në shfrytëzim të perhershëm ngastra kad. Nr. 98/4 në siperfaqe prej S=0.04.50 ha e shenuar më lartë Hajdar Hetës nga Drenasi (në kohën e masave të dhunshme të Serbisë).

Me vonë me aktvendimin 07.nr.351-209 të dt. 12.07.1993 l ipet leja për ndertimin e objektit në ate vend gjegjësisht në truallin-ngastrën kad. Nr.98/4 në Qikatovë të Re.

-Mer aktvendimin nr.,952/290 të dt. 19.10.2005 nga Drejtorati për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë l rrefuzohët kërkesa për rexhistrimin e këtijë trualli në emer të Hajdar Hetës.

-Hajdar Heta ka vazhduar me ankesë në AKK në Prishtinë dhe AKK-ja me konkluzionin nr.03/879/09 të dt.879/09 të dt.1.07.09 e urdhëron Drejtoratin për Kad. Gjeod. dhe Pronë që ta vendos kërkesën e Hajdar Hetës në procedurë ligjore.

-Me Aktgjykimin e Gjykatës themelore në Prishtinë –departamenti për qeshtje administrative nr. 986/2009 të dt. 11.06.2013 është rrefuzuar kërkesëpadia e Komunës se Drenasit e cila e ka paditur AKK-n në Prishtinë për këtë regjistrim të kësaj prone.

-Pas rexhistrimit në RDPP të kësaj prone në emer të Hajdar Hetës nga Drenasi, me Qertifikatën mbi të drejtat e pronës se paluajtshme të azhuruar me datë 15.07.2015 e ka nxjerr nga Drejtorati për kad. Gjeod. dhe Pronë Qertifikata e pronës në emer të Hajdar Hetës jo si shfrytëzues l perhershëm l pronës komunale por si lloj l pronës privat.

Komisioni konstaton se procedura administrative lidhur me këtë ngastër kadastrale ka parregullsi edhe pse Drejtorati për kadaster gjeodezi dhe Pronë ia ka rrefuzuar rrethimin e pronës së H.Hetës në RDPP.

Kur themi se ka parregullsi rreth zbatimit të ligjshmerisë për këtë truall nga se Hajdar Heta e ka marrë në kohën e masave të dhunshme, edhe Lejën e ndërtimit të objektit, por i njëjti nuk ka ndërtuar kurrë, që është në kundërshtim me ligj sepse pas kalimit të afatit prej tre vjetësh nese nuk ka bërë ndërtim në atë vend e ka humbur të drejtën e ndërtimit (kur edhe e ka pas lejen e ndërtimit nga organi i dhunshëm).por që nuk e ka shfrytëzuar.

Komisioni konstaton se për këtë lëndë pasi që është një lëndë e vjetër nuk kemi mundur me verifikuar në tersi procedurat administrative ligjore të asaj prone, andaj nuk kemi rekomandim për zyrën e Kryetarit të komunës.

III. Komisioni pas nxjerrjes së Qertifikatës mbi të drejtat e pronës së Paluajtshme e cila në vetë ka ngastër kad. Nr. 726/15 e cila është e titulluar pronë komunale dhe e ka sipërfaqën prej S=1.32.00 ha .E njëjta është e azhuruar sipas të dhënave në qertifikatë me datë:25.01.2016.

Në dokumentacion komisioni ka hulumtuar dhe ka gjetur të dhëna se ngastra kadastrale nr. 726/15 z.kad. Drenas (te stacioni i autobusve) i është dhënë me koncesion Ndermarrjes tregtare-sherbyese "Vëllezerit Thaqi" me një Marveshtje të partneritetit publiko-privat nën numrin e protokollit 01.nr.344-123 be dt.04.01.2013 e nënshkruar nga ish kryetari Demaku dhe për firmën "Vëllezerit Thaqi" pronar Mehdi Thaqi.

Kjo marveshtje është regjistruar në RDPP me vendim të Kuvendit të Komunës (i cili vendim është nën numrin e protokollit nr.344-8473 e dt.11.06.2012 në zyrën për RDPP) të Komunës së Drenasit.

E kemi present Qertifikatën mbi të drejtat e pronës nr.344-12477 e azhuruar me dt.18.04.2013 gjegjësisht ngastra kad. Nr. 726/15 në sipërfaqe prej S=1.32.00 ha.z.kad. Drenas.

Në dokumentacion kemi edhe Vendimin e Kuvendit të Komunës 12.nr.344-12477 të dt. 05.03.2015 me të cilin anulohet vendimi i Komunës së Drenasit nr.344-8473 i dt. 11.06.2012 për dhënjën me koncesion të Stacionit të autobusve me objektet percjellëse.

Me aktvendimin 12.nr.344-12477 të dt. 21.01.2016 bëhet regjistrimi i shfrytëzimit për 40 vite të ngastres kad nr,726/15 në sipërfaqe prej S=1.32.00 ha prej Ndermarrjes "Vëllezertit Thaqi"

Me draft qertifikatën e pronës të lëshuar me dt. 13.03.2018 del se ngastra kadastrale nr. 726/15 në sipërfaqe prej S=1.32.00 ha ka kaluar në emër të Pronës Komunale sipas azhurimit në RDPP me datë25.01.2016 Komisioni në vazhdim trajtoi edhe dokumentacionin për ngastër kadastrale nr. 726/15 e cila ngastër kadastrale është në zonën kadastrale në Drenas-të stacioni i autobusve.

Me vendimin nr. 463-34434 të dt. 20.06.2016 Kuvendi I Komunës se Drenasit I ka dhenë në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite kompanisë "VALDRINI" shpk pronën komunale gjegjësisht ngastrën kadastrale nr. 726/15 në sipërfaqe prej S=1.22.00 ha në zonën kadastrale në Drenas

Sipas vendimit vlere e investimit në atë ngaster kadastrale ka qenë 460.000.00 euro nga ana e kompanisë "Valdrini" pastaj punësimi i 6 punëtorve etj.

Në dokumentacion kemi edhe qertifikatën mbi të drejtat e pronës për ngastrën kad. 726/7 e cila e ka sipërfaqën prej S=0.06.00 ha e titulluar me pronar - pronë komunale-shfrytëzues KNI"Ramiz Sadiku" e azhuruar në RDPP.

Prandaj konstatohet se në RDPP është rexhistruar në bazë të kontratës 01.351-259 e dt. 06.03.2004 e cila kontratë është e nënshkruar nga kryeshefi i Komunës se Drenasit Avdyll Krasniqi dhe përfaqësuesit të KNI"Ramiz SADIKU" Gani Sopi.

Lidhur me pronën e KNI"Ramiz Sadiku" të ngastra kad. Nr. 726/7 në sipërfaqe prej S=0.06.00 ha, tash nga RDPP-ja na del edhe një kontratë me nr. 184 e dt. 25.05.2005 në mes të KNI"Ramiz Sadikut" si shitës dhe Selmani Sinanit si blerës e që nga ajo sipërfaqe e objektit ka blerë sipërfaqën prej 90.14 m². dhe me vonë me një aneks kontratë me nr. 184/1 të dt. 08.06.2005 edhe sipërfaqën prej 53 m².

Pastaj Qertifikatën mbi të drejtat e pronës për ngastrën kad. Nr. 726/10 në sipërfaqe prej S=0.01.67 ha e titulluar pronë Komunale e Komunes se Drenasit.

Kur i zbriten sipërfaqët e ngastrës kad. Nr. 726/7 dhe 726/10 atëherë sipërfaqëja e ngastrës kad. Nr. 726/15 e cila është pronë komunale e Komunës se Drenasit e ka sipërfaqën S=1.32.00 ha

Nga komisioni konstatohet se kjo ngaster kadastrale nuk ka psuar ndryshime edhe pse me vendim të Kuvendit të Komunës se Drenasit I është dhenë në shfrytëzim për 45 vite Kompanisë "Valdrini" shpk.

Me që nuk ka ndryshime në rexhistrim të kësaj kompanie për këtë pronë në sistemin e RDPP-es I rekomandohet zyrës se kryetarit të Komunës që këtë vendim për dhenjë të pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë kompanisë "Valdrini" shpk. Ta shfuqizoj me një propozim-vendim në ndonjë mbledhje të ardhshme të Kuvendit të Komunës se Drenasit.

IV. Komisioni gjithashtu trajtoj dhe verifikoj komplet procedurën administrative-ligjore dhe dokumentacionin lidhur me ngastrat kadastrale nr. 127 e cila është pronë private dhe ngastrën kad. Nr. 720 e cila është pronë komunale e Komunës se Drenasit e që të dyja janë në zonën kadastrale në Korroticë të Ulët.

Për keto dy ngastra kadastrale veq I kemi në dokumentacion qertifikatat e gjithashtu për pronën e cila është pronë private e kemi edhe aktvendimin e zbatimit të masës se komasacionit në emër të Adem A. Ahmetit, dhe dy kopjet e planit për të dy ngastrat kadastrale.

Komisioni konstatoi se ekziston edhe Vendimi I Kuvendit të Komunës se Drenasit 12.nr.353-12312 I dt.04.03.2015 me të cilin lejohët dhe aprovohët nga ana e kuvendit kembimi I pronës se Komunës (pronë komunale –pjesë e ngastres kad. Nr.720/2) me pronën private të Muhamet Adem Ahmetit-trashigimtar I Adem Ahmetit nga Korrotica e Ultë (pjesa e ngastres kad. 127 sipas aktvendimit të koamasacionit461-46 të dt. 02.07.1987.

Qellimi I ketijë kembimi të pronave sipas vendimit është zgjerimi I lokacionit të varrezave të fshatit Korroticë e Ultë.

Per ketë vendim në dokumentacion është edhe konfirmimi I ligjshmeris se ketijë vendimi nga ana e MAPL në Prishtinë nr.0204-378/8 I dt.14.04.2015.

Na mungon Aktvlersimi I pronës komunale dhe pronës private që është lendë e kembimit të pronave sipas vendimit të Kuvendit të Komunës se Drenasit.

Në dokumentacion kemi edhe kerkesën nga Komuna që ia ka drejtuar ZVPP-e per vlersim te pronave me datë 31.08.2016.

Pastaj Kerkesën tjeter nr. 942/3556 të dt. 28.06.2017 për vlersim të serishem të pronës komunale dhe private në zonën kadastrale në Korroticë të Ultë e cila pronë është në procedurë të kembimit.

Pergjigjëjen nga ZVPP-ja drejtuar Zyrës se Kryetarit të Komunës se Drenasit nr.09-2178/1 të dt. 06.07.2017,dhe pergjigjëjen tjeter zyrtare prap nga ZVPP nr. 09-2178/20 të dt. 17.08.017

Pas trajtimit të të gjitha shkresave për ketë lendë, komisioni konstaton se procedurat zyrtare - administrative edhe pse me vonës janë kryer nga Drejtorati për gjeod.kad. dhe Pronë ne bashkpunim me Drejtoratin për Urbanizem duke e zbatuar Vendimin e Kuvendit të Komunas se Drenasit 12.nr. 353-12312 të dt.04.03.2015.

Të vlersimi I pronave të cilat janë në procedurë të kembimit verhet se vlersimi I pronave ndryshon shumë pak në raport të pronës private të personit fizik që është afer varrezave me pronën komunale që është buzë rrugës se asfaltuar,por vlersimin e ka berë ZVPP në nivel të Ministrisë se financave të Republikës se Kosovës.

Duke mos e zbatuar Vlersimin e komisionit për vlersimin e pasurisë paluajjtshme nr. 03-421-24986 të dt. 12.06.2014 të Komunës se Drenasit e posaqerisht të faqëja 13 dhe 14 e ketij dokumenti zyrtar per vlersim të pronave në veqanti ngastra kadastrale nr. 127 qe është prone private të varrezat e fashtit Korroticë të ultë dhe e cila ka qenë në emer të pronarit të vdekur kur ka vendos kuvendi I Komunes se Drenasit dhe ngastra kad.720/2 pronë komunale buzë rrugës të shkolla afer Sh.F.M.në Korroticë të ultë.

Korroticë

Gjithashtu komisioni konstaton se ka vërejtje në aspektin e procedurave të kembimit të pronës komunale me person fizik para se me shkuar në Kuvend të Komunës për aprovim pasi që prona e personit fizik gjegjësisht ngastra kad. Nr. 127 ka qenë e përfshirë në zonë komasative, nuk është hulumtuar sa duhet para se me dal në Kuvend se a ka prona tjera në atë zonë kadastrale e cila mund të shfrytëzohet për varreza. (kopja e vlersimit faqe 13 dhe 14)

Komisioni I rekomandon zyrës së Kryetarit të Komunës:

1. Që të paraqes propozim vendim në Kuvend të Komunës së Drenasit për shfuqizimin e Vendimit të Komunës së Drenasit 12.nr.353-12312 të dt.04.03.2015 me arsyetim se ZVPP në Prishtinë nuk e ka bërë vlersimin e pronave si duhet si dhe procedurat administrative të atyre pronave që gjenden nën masë e komasacionit në kembim në Z.kad. Korroticë e Ulte para se me dal në Kuvend komunal për aprovim nuk kanë qenë në harmoni me ligj për shkak të zbatimit të masës së komasacionit në atë zonë kadastrale.

V. Të ngastra kadastrale nr. 295/1 nga dokumentacioni të cilën të cilin e kemi trajtuar ne si komision kemi vërejtur dhe I kemi present :

- Vendimin e Kuvendit të Komunës së Drenasit 12.nr.463-16574 të dt.25.03.2015 përmes secilit I është dhënë në shfrytëzim prona e paluajtshme ,gjegjësisht ngastra kadastrale nr. 295/1 Z.Kad. sankoc në sipërfaqe prej S=1.00.00 ha Firmës "Fazani" shpk. Sankoc me pronar Hashim Rexhepi nga Zabeli I Epër.

Pas këtij vendim është bërë edhe kontrata e shfrytëzimit dhe është nënshkruar kontrata në mes të Kryetarit të Komunës së Drenasit dhe Hashim Rexhepit nga Zabeli I Epër. (kontrata 01.nr. 463-45999 e dt. 31.08.2015) në kohëzgjatje prej 15 vite..

-Pastaj Vendimi tjetër I Kuvendit të Komunës së Drenasit 12.nr.463-16570 I dt. 25.03.2015 me të cilin I ipet në shfrytëzim paluajtshmeria, gjegjësisht ngastra kadastrale nr.295/8 në sipërfaqe prej S=5.00.00 ha zona kadastrale në Sankoc fermerit Afrim Rashiti nga Sankoci.

Pas këtij vendim është hartuar edhe kontrata 01.nr. 463-17095 e dt. 31.03.2016 në mes të Kryetarit të Komunës dhe fermerit Afrim Rashiti nga Sankoci në kohëzgjatje prej 15 vitesh.

Sipas të dhënave nga Enver Hoxha zyrtar financiar dhe anëtar I komisionit del se për këto dy kontrata ,nga kontraktuesit janë kryer obligimet ndaj komunës në aspektin e pagesave obligative.

Ndërsa këto dy kontrata nuk janë të rexhistruara në RDPP edhe pse ka qenë obligim ligjor për tu rexhistruar si pronë më qerambajtje në RDPP.

2
7 Sankoc

-Gjithashtu është present para komisionit edhe vendimi tjetër I Kuvendit të Komunës se Drenasit 12.nr.463-16568 I dt. 25.03.2015 me të cilin I aprovohet dhenja e pronës se paluajtshme në shfrytëzim gjegjësisht ngastra kadastrale nr. 295/1 në sipërfaqe prej S=10.00.00 ha fermerit Rashit Rashitit nga Sankoci .

Ky vendim ka mbetur vetëm si vendim dhe kontratë të hartuar e as të nënshkruar në emër të këtij vendimi nuk kemi (dmth ka mbetur vetëm vendim në letër).

Komisioni konstaton se Kontrata e marrjes në shfrytëzim të pronës se paluajtshme komunale perkohësisht nga Afrim Rashiti nga Sankoci dhe Hashim Rexhepi nga Zabeli Eper për firmën "FAZANI" janë legale por pasi që ato prona nuk janë të parcelluara në vend dhe nuk janë e futur në RDPP, Komisioni komunal për dhënje të pronave komunale në shfrytëzim duhet të që ti thrras zyrtarisht për kjarësimin e kontratave ,ndersa vendimi për dhenjen e pronës komunale në shfrytëzim të perkohshem Rashit Rashitit të dergohet në Kuvend me propozim për shfuqizim të atij vendimi pasi që për te nuk kemi kurfar dokumenti se ka filluar punën sipas vendimit të Kuvendit të komunës.

Komisioni gjithashtu trajtoj edhe procedurës se dhenjes në shfrytëzim të pronës komunale të Komunës, gjegjësisht ngastrës kad. Nr. 144/2 në sipërfaqe prej S=0.31.00ha në zonën kadastrale në Polluzhë e cila ngaster I është dhenë në shfrytëzim të perkohshem në afat prej 10 vitesh kompanisë shpk.HITCHENERGY KOSOVA të cilin e perfaqson Ali Kastrati nga Polluzha. Sipas kontratës të lidhur në mes të kryetarit të komunës Demaku dhe Ali Kastratit nga Polluzha.

Kjo kontratë qenka hartuar në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal të Drenasit nr.12.nr.351-183 dt. 31.12.2004.

De fakto kjo pronë edhe tani është në pronësi të Komunës se Drenasit pasi që kompania e cila e ka marrë në shfrytëzim atehere nuk ka vazhduar metej dhe nuk e ka futur rëxhistrimin e sajë në RDPP.

Komisioni konstaton se pasi që të ngastra kadastrale 144/2 në z.kad. Polluzhë nuk është e rëxhistruar në RDPP I propozon zyrës se Kryetarit që me propozim vendim të shfuqizon vendimin e atehershem të komunës se Drenasit.

Drenas:14.03.2018

KOMISIONI

1.Halim Prokshi

2.Mehdi Kurrumeli

3.Safet Hoxha

4.Flora Krasniqi

5.Enver Hoxha

